



**Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°28/2022

Hagë, 21/07/2022

Përditësim

Mirë se vini në informimin javor për median të Dhomave të Specializuara të Kosovës, ku synojmë t'ju ofrojmë gazetarëve një përditësim mbi zhvillimet e fundit në Gjykatë dhe mundësinë për të drejtuar pyetje.

Më 19 korrik, Paneli i Gjykatës së Apelit hodhi poshtë apelin e z. Pjetër Shala në lidhje me vendimin e Gjykatës të Procedurës Paraprake mbi vazhdimin e paraburgimit të tij.

Më 20 korrik, Trupi Gjykues I urdhëroi vazhdimin e mbajtjes në paraburgim të z. Salih Mustafa. Trupi Gjykues konstatoi se vazhdon të ekzistojë rreziku që i akuzuari të pengojë ecurinë e procesit përmes ndërhyrjes ndaj viktimave dhe dëshmitarëve, dhe/ose familjeve të tyre.

Trupi Gjykues gjithashtu konstatoi se, nëse lirohet, asnjë kusht i vendosur prej Trupit Gjykues, nuk do të zvogëlonte në masë të mjaftueshme rrezikun e pengimit të ecurisë së procesit dhe rrjedhimisht i akuzuari duhet të mbetet në paraburgim.

Trupi Gjykues më tej vuri në dukje se periudha që z. Mustafa ka kaluar në paraburgim është e arsyeshme, duke pasur parasysh se nuk ka pasur asnjë periudhë ndërprerjesh në procesin kundër të akuzuarit. Trupi Gjykues vëren konkretisht se: (1) gjykimi filloi, sipas planifikimit, më 15 shtator 2021; (2) ZPS-ja përfundoi paraqitjen e provave më 4 shkurt 2022; (3) Mbrojtja përfundoi paraqitjen e provave më 26 maj 2022; (4) Trupi Gjykues përfundoi procedurën e paraqitjes së provave më 20 qershor 2022; dhe (5) seanca për deklaratat përmbyllëse është planifikuar për 13-15 shtator 2022.

Ndër lajme të tjera, periudha e pushimit të DHSK-së do të fillojë të hënën, më 25 korrik deri më 12 gusht 2022. Gjatë kësaj periudhe nuk mbahen seanca dhe disa nga shërbimet jothelbësore do të jenë në minimum. Megjithatë, gjykata mbetet plotësisht funksionale dhe puna vazhdon në të gjitha seksionet e DHSK-së. Gjatë pushimit mund





**Informim javor për median
Dhomat dhe Zyra Administrative**

N°28/2022

Hagë, 21/07/2022

të paraqiten parashtrime dhe përveç nëse gjykatësit kanë urdhëruar ndryshe, afatet gjyqësore vazhdojnë të jenë në fuqi.

Nuk do të ketë informim javor për median gjatë pushimit të gjykatës, që do të thotë se informimi javor i ardhshëm për median është planifikuar për 18 gusht, në orën 14:30.

Pyetje nga gazetarët

Nuk pati pyetje.

